

# SBASHK Arsimimi sot

Shkurt, 2025

Gazeta elektronike

## Jasharaj i vizitoi mësimdhënësit që po e ndjekin trajnimin në Prishtinë



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i ka vizituar mësimdhënësit të cilët po e ndjekin trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” në Qendrën Burimore “Përparimi” në Prishtinë. Jasharaj u informua nga afër me mbarëvajtjen e trajnimit që po zhvillohet në këtë shkollë ku po mbahen dy grupe të trajnimit paralelisht, njëri të shtunën dhe njëri të dielën, nga trajneri i përzgjedhur nga SBASHK, Nexhmedin Gruda. Jasharaj pati rast të diskutoj nga afër ... (faqe 4)

## SBASHK pjesë e rëndësishme e diskutimeve evropiane për barazinë në arsim!



Përfaqësuesit e SBASHK-ut, me ftesë të kryetarit të PDK-së, Bedri Hamza, u pritën nga ky i fundit gjatë muajit dhjetor të vitit 2024 ... (faqe 7)

## Bisedë me veprimtarin sindikal Fejzullah Vranovci



Krenar me profesionin e mësuesit dhe me angazhimin në SBASHK ... (faqe 3)

## SBASHK përgatitet për 7 Marsin, Ditën e Mësuesit



Nga aktivitetet e veçanta në institucionet arsimore dhe në SBASHK gjatë muajit shkurt janë edhe përgatitjet për të lartësuar kujtimin për komandantin legjendar Adem Jashari ... (faqe 2)

## Në shkurt SBASHK organizoi 21 grupe të trajnimit



SBASHK të shtunën e 22 shkurtit filloi me nëntë grupe të trajnimit në programet “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” në disa komuna ... (faqe 5)

## Editorial

### SBASHK përgatitet për 7 Marsin, Ditën e Mësuesit



Nga aktivitetet e veçanta në institucionet arsimore dhe në SBASHK gjatë muajit shkurt janë edhe përgatitjet për të lartësuar kujtimin për komandantin legjendar Adem Jashari dhe gjithë dëshmorët e kombit duke u bërë pjesë e Manifestimeve të Epopesë së UÇK-së. Po ashtu SBASHK bën edhe angazhime të shumta me qëllim që të shënohet në mënyrë festive dita e madhe e mësuesit dhe shkollës shqipe. Mësimdhënësit bashkë me nxënësit do të organizojnë aktivitete artistike dhe përmes këngës e fjalës artistike do të lartësojnë kujtimin dhe do të shprehin krenarinë për dëshmorët kombit, që flijuan jetën e tyre për t'i sjellë lirinë atdheut. Në këto aktivitete do të lartësohet kujtimi edhe për

pishtarët e dijes që nëpër vite e dekada ishin në krye të misionit të shenjtë për edukimin e arsimimin e brezave. SBASHK-u duke shprehur respekt meritore për koleget e kolegët tanë që janë pensionuar nga marsi i vitit të kaluar e deri tani do të ndajë mirënjohje dhe në gjithë komunat e Kosovës do të organizohen aktivitete e takime falënderimi me ta. Respekt i përhershëm për pishtarët e dijes që mbrojtën rrezet e dritës kundër errësirës. I përhershëm kujtimi për Epopenë e lavdishme të UÇK-së, për komandantin legjendar Adem Jashari dhe gjithë heronjtë e dëshmorët e kombit, që i ndërruan kahjen historisë dhe u bënë gurthemel të lirisë së Kosovës.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spotete në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel: +383 (0) 38 226 940



## Intervista

### Bisedë me veprimtarin sindikal Fejzullah Vranovci



Bisedë me veprimtarin sindikal Fejzullah Vranovci, krenar me profesionin e mësuesit dhe me angazhimin në SBASHK. Fejzullah Vranovci është kryetar i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për komunë në Ferizajt. Me vite e dekada kreu me përkushtim misionin e shenjtë për arsimimin dhe edukimin brezave. Fejzullahu me vite u shqua edhe si veprimtar sindikal dhe arsyetoi besimin e kolegeve e kolegëve nga komuna e tij duke kryer me përkushtim detyrën e kryetarit. Ai para pak ditësh u pensionua dhe në shenjë respekti meritore për angazhimet e tij të shumta sindikale në këtë numër të gazetës sonë po publikojmë një bisedë përmbajtjesore që kemi zhvilluar me të. Fejzullahu flet me admirim për profesionin

e mësimeve dhe shprehët se ai bashkë me gjithë koleget e kolegët e tij në Ferizaj dhe në gjithë Kosovën janë munduar që të realizojnë me përpikëri misionin e shenjtë për arsimimin e edukimin e brezave. Fejza, si shumë nga mësuesit tjerë në Kosovë me krenari kujtojnë kontributin madhor që kanë dhënë në vitet e 90-ta duke mbrojtur dritën kundër errësirës. Fejza me të drejtë vlerëson se vitet e 90-ta për arsimin shqip në Kosovë janë vite krenari dhe etapë e lavdishme, sepse janë bërë përpjekje dhe sakrificat sublime në mbrojtje të gjuhës, historisë dhe kulturës kombëtare dhe ky mision është kryer me sukses falë angazhimit edhe të SBASHK-ut që në ato vite dha kontribut të lartë duke krijuar unitet në rrugëtimin e gjatë për mbrojtjen e arsimit shqip. Fejza kujton edhe vitet e pasluftës dhe kontributin e lartë që vazhduan ta japin punëtorët arsimor në rindërtimin e atdheut dhe në rifillimin e betejave për dije në kushte tepër të vështirë dhe në objekte të dëmtuara rëndë nga pushtuesi.

Fejza kujton me krenari edhe aktivitetet e shumta të SBASHK-ut në komunën e tij, aktivitete këto që e kanë bërë të dallohet për të mirë kjo komunë. Ai po ashtu flet me respekt edhe për angazhimet e kolegeve e kolegëve të tij në komunat tjera dhe në universitete dhe të stafit qendror, që kanë bërë angazhime të vazhdueshme dhe kanë dhënë kontribut të vazhdueshëm në shërbim të anëtarësisë. Fejzullahu apelon të gjithë anëtarësia që të vazhdojnë me angazhimet dhe ta ruajnë unitetin e krijuar nëpër vite e dekada, sepse SBASHK-u është mbrojtës i dëshmuar i të drejtave të punëtorëve arsimor dhe gëzon respekt meritore në Kosovë, por edhe kudo mes sindikatave simotra në Ballkan, Evropë e tërë botën.

SBASHK-u i uron pensionimin Fejzullahut duke e falënderuar për gjithë angazhimet dhe kontributin e dhënë në edukimin e arsimimin e brezave dhe në aktivitetet sindikale.

## Gjatë muajit

### Jasharaj i vizitoi mësimdhënësit që po e ndjekin trajnimin në Prishtinë




Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i ka vizituar mësimdhënësit të cilët po e ndjekin trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” në Qendrën Burimore “Përparimi” në Prishtinë.

Jasharaj u informua nga afër me mbarëvajtjen e trajnimit që po zhvillohet në këtë shkollë ku po mbahen dy grupe të trajnimit paralelisht, njëri të shtunën dhe njëri të dielën, nga trajneri i përzgjedhur nga SBASHK, Nexhmedin Gruda.


Jasharaj pati rast të diskutoj nga afër edhe me mësimdhënësit

që po e ndjekin këtë trajnim, të njihet nga afër me problemet, kërkesat dhe shqetësimet që i preokupojnë ata si dhe u ofroi mbështetjen e SBASHK-ut si çdoherë.

SBASHK të shtunën ka filluar edhe me një grup të ri të trajnimit në Rahovec në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajner Skender Gashi. Derisa po vazhdojnë trajnimet e filluara javëve të kaluara në qytete të ndryshme si Podujevë, Prizren, Pejë, Gjiilan, Klinë e Fushë Kosovë.



### Në Viti u mbajt testi për një grup të mësimdhënësve



Në Viti u organizua testi për mësimdhënësit të cilët e përfunduan trajnimin në programin: Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie.

Testi u administrua nga Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtarja, Nezafete Jakupi.

Ndërsa trajnimi ishte udhëhequr nga trajneri i përzgjedhur nga SBASHK, Musli Neziri.

SBASHK ka vazhduar me dhjetëra grupe të trajnimit të cilat po mbahen në komuna të ndryshme të Kosovës, ku vetëm këtë vikend filluan 12 grupe të reja.



## Në muajin shkurt, SBASHK organizoi 21 grupe të trajnimit

SBASHK të shtunën e 22 shkurtit filloi me nëntë grupe të trajnimit në programet “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” në disa komuna të Kosovës si Prishtinë, Gjakovë, Klinë, Fushë-Kosovë, Pejë, Malishevë e Rahovec.



Në kuadër të programit “Aplikimi i Programeve Kompjuterike në Mësimdhënie”, dy grupe trajnimi filluan punën të shtunën në Prishtinë, nën udhëheqjen e trajnerëve Nexhmedin Gruda dhe Arben Zymeri. Ndërkohë, grupi i tretë filloi të dielën, po ashtu me trajner Nexhmedin Gruda.



Këto dy grupe trajnimi u vizituan nga Sekretari i Përgjithshëm i SBASHK-ut, Ymer Ymeri, i cili bashkëbisedoi me pjesëmarrësit lidhur me përvojat e tyre gjatë trajnimeve, rëndësinë e përvetësimit të aftësive digjitale në mësimdhënie dhe çështje të tjera me interes për anëtarësinë e SBASHK-ut. Ai theksoi se ky program synon të fuqizojë mësimdhënësit me njohuri praktike, duke i pajisur ata me mjete që lehtësojnë procesin mësimor dhe rrisin efikasitetin e tyre në klasë.



Një grup i trajnimit filloi të shtunën edhe në Klinë në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajner Fejzullah Berisha, derisa grupi i dytë nisi të dielën në këtë komunë po me këtë trajner të përcaktuar nga SBASHK-u.

Një grup i trajnimit të shtunën filloi edhe në Gjakovë në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajnerë Litvana Spahija, derisa të dielën filloi edhe grupi i dytë i trajnimit me të njëjtin program dhe me të njëjtën trajnerë të përcaktuar nga SBASHK-u.



Një grup i trajnimit të shtunën filloi edhe Malishevë në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajner Albert Samadrixha si dhe një grup filloi në programin e njëjtë në Fushë-Kosovë, me trajnerë Blerona Ahmeti.



Ndërkohë, dy grupe të trajnimit filluan në Pejë në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” me trajnerët e përcaktuar nga SBASHK: Addhe Krasniqi dhe Ilir Gashi si dhe një grup në programin e njëjtë në Rahovec, me trajner Gani Kryeziu.



# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Gjatë kësaj jave po ashtu filluan dy grupe të trajnimit në Podujevë, me trajner Kadri Hyseni.



Paraprakisht, SBASHK kishte filluar edhe me 9 grupe tjera të trajnimit në fillim të muajit shkurt, derisa kishte organizuar testet për dy grupe të mësimdhënësve.



Të shtunën e 1 shkurtit SBASHK kishte filluar me katër grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” në Prizren, me trajnerët e përzgjedhur nga SBASHK: Arton Ajeti, Ermal Ahmetaj, Naser Kastrati dhe Nexhat Maçkaj si dhe një grup në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” me trajnerë Arlinda Lamaj. Në Podujevë më 1 dhe 2 shkurt 2025 kishin filluar edhe dy grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajner Kadri Hyseni, derisa një grup i trajnimit kishte nisur

në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” me trajnerë Nora Haliti.



Po ashtu në fillim të muajit shkurt, në Gjilan kishin filluar dy grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajnerë Ibadete Limani kurse në Rahovec ishte mbajtur një grup i trajnimit po ashtu në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, me trajnerin e përzgjedhur nga SBASHK, Skender Gashi.



## SBASHK u përfaqësua në trajnimin e rëndësishëm të ETUI-ETUCE në Bruksel!



Më 20-21 shkurt 2025, në Bruksel u zhvillua trajnimi i përbashkët i Institutit të Sindikatave Evropiane (ETUI) dhe Komitetit të Bashkimit Evropian për Arsimin (ETUCE) me temën “Ndikimi i teknologjive të IA-së në barazinë dhe përfshirjen në arsim”.

SBASHK ishte i pranishëm në këtë ngjarje të rëndësishme, duke kontribuar krahas të gjitha sindikatave nga shtetet evropiane.

Ky trajnim sjell diskutime mbi rolin e Inteligjencës Artificiale në arsim, sfidat që sjell për mësimdhënësit dhe nxënësit, si dhe strategjitë sindikale për të siguruar një arsim gjithëpërfshirës dhe të drejtë.

Pjesëmarrja e SBASHK-ut në këtë trajnim nënvizon angazhimin për një arsim cilësor dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të arsimit në Kosovë.



## SBASHK pjesë e rëndësishme e diskutimeve evropiane për barazinë në arsim!



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) mori pjesë në takimin e Komitetit të Përhershëm për Barazi të ETUCE, i cili i mbajt më 18-19 shkurt 2025 në Bruksel e ku morën pjesë 47 përfaqësues të vendeve të ndryshme nga Evropa.

SBASHK ishte përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, i cili kontribuoi përkrah përfaqësuesve të shteteve evropiane në diskutime të rëndësishme mbi barazinë, përfshirjen dhe të drejtat e mësimdhënësve dhe nxënësve. Ky ishte një moment i rëndësishëm që dëshmon se Kosova ka zërin e saj të barabartë në tryezat evropiane të arsimit, duke ndikuar në politikat që sigurojnë një sistem arsimor më të drejtë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë. SBASHK vazhdon të jetë zë i fuqishëm për mësimdhënësit e Kosovës në nivel ndërkombëtar!

Gjatë ditës së parë të takimit të përhershëm të ETUCE-së për barazinë janë diskutuar disa tema të ndryshme si: Barazia gjinore dhe përfshirja në arsim – Strategjia për të adresuar pabarazitë dhe diskriminimin në shkolla dhe institucione arsimore, kushtet e punës dhe të drejtat e mësuesve në Evropë – Politikat për pagë të barabartë, sigurina në vendin e punës dhe bilancin punë-jetë.



Digjitalizimi dhe barazia në arsim – Si të sigurohet që teknologjia të përdoret për të promovuar përfshirjen dhe jo për të thelluar hendekun arsimor etj. Po ashtu, gjatë këtij diskutimi është propozuar të hartohet një “Udhëzues mbi Politikën e Barazisë dhe Përfshirjes në Arsim”, dokument ky që përmban rekomandime të qarta për hartimin dhe zbatimin e politikave të barazisë në sistemin arsimor, përfshirja e mekanizmave për

mbrojtjen nga diskriminimi, trajnime për mësuesit dhe masa për një ambient më gjithëpërfshirës në shkolla. Gjatë kësaj tryeze është diskutuar edhe dobia e bazave online të praktikave të mira dhe mënyra se si mund të përmirësohet një gjë e tillë. Në diskutim u konkludua se baza online e praktikave të mira është e dobishme, por mund të përmirësohet duke shtuar raste konkrete nga vende të ndryshme, për të mësuar nga përvojat më të mira, duke krijuar një sistem filtrimi për praktikat e mira sipas vendit, llojit të shkollës dhe fushës së barazisë si dhe duke shtuar burime dhe modele të politikave që mund të përdoren drejtpërdrejt nga sindikatat dhe shkollat.

Po ashtu në takimin e ETUCE-s ku po marrin pjesë 47 pjesëmarrës nga shtete të Evropës, u shtrua nevoja për organizimin e një seminari online me temën “Përfshirja e grupeve të marginalizuara në arsim”, i cili do të ishte shumë i vlefshëm për Kosovën dhe Shqipërinë, e që do të mbahej me mbështetjen e Komitetit të Përhershëm. SBASHK gjatë muajit shkurt u përfaqësua edhe në Barcelonë të Spanjës në punëtorinë trajnuese “Your Turn 2: Teachers for Trade Union Renewal” – “Radha Juaj 2: Mësimdhënësit për Rinovimin e Sindikatave” e cila u mbajt më 25-26 shkurt 2025, nën organizimin e Komitetit Evropian të Sindikatave të Arsimit (ETUCE).



Në këtë ngjarje morën pjesë sindikatat anëtare të ETUCE nga e gjithë Evropa, përfshirë edhe përfaqësuesit e SBASHK-ut, Nënkryetaren Vjollca Shala dhe Sekretarin e Përgjithshëm Ymer Ymeri.



Gjatë kësaj punëtorie, pjesëmarrësit diskutuan mbi përvojat dhe strategjitë për fuqizimin e sindikatave të arsimit, rikthimin e tyre në qendër të vendimmarrjes dhe mbrojtjen më të mirë të të drejtave të mësimdhënësve. Përfaqësuesit e SBASHK-ut ndanë përvojat e Kosovës në organizimin sindikal, sfidat e sektorit të arsimit dhe hapat që duhen ndërmarrë për një përfaqësim më të fuqishëm sindikal.

## Urime 17 vjetori i pavarësisë së Kosovës



Kolege e kolegë që nga çerdhet e deri në universitete, urime ditën e pavarësisë së shtetit tonë. Në çdo 17 shkurt lartësojmë kujtimin për luftëtarët e lirisë dhe për pishtarët e dijes që me nga sublime i sollën lirinë dhe pavarësinë atdheut tonë. SBASHK ua uron këtë festë të madhe punëtorëve të arsimit, policisë e ushtrisë, mantelbardhëve, punëtorëve të administratës dhe gjithë të punësuarve në sektorin publik dhe në sektorin privat.

Gëzuar!  
Festa e gëzime paçi gjithonë.

### Udhëheqësit e SBASHK-ut vizituan të shtunën disa grupe të trajnimit

Nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe sekretari i përgjithshëm, Ymer Ymeri, ndërkohë gjatë muajit shkurt i kanë vizituar disa grupe të trajnimit të cilat po mbahen në komuna të ndryshme të Kosovës.



Nënkryetarja Shala vizitoi katër grupe të trajnimit që po mbahen në shkollën "Ymer Prizreni" në Prizren, të cilët po e vijnë trajnimin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie", serisa u njoh nga afër me mbarëvajtjen e tij.

Po ashtu, sekretari i përgjithshëm më SBASHK, Ymer Ymeri, e kishte vizituar një grup të mësimdhënësve të cilët po e ndjekin trajnimin në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie" në Gjilan. Ymeri aty ishte i shoqëruar edhe nga këshilltari për Arsim në komunën e Bujanocit, Agim Hasani dhe kryetari i SKAP-it për Gjilan, Blerim Mehmeti. SBASHK po vazhdon mbajtjen e trajnimeve për mësimdhënësit anëtarë të Sindikatës edhe në komuna tjera si Podujevë, Pejë, Rahovec e Viti.

